



LETËR E HAPUR

KUNDËR HAPJES SË KONSULLATËS SERBE NË SHKODËR

I bëjmë thirrje institucioneve Shqiptare të zhvillojnë një proces transparent, me konsultim publik dhe një analizë të plotë të interesit kombëtar.

**SEPSE VENDIMET QË PREKIN IDENTITETIN
KOMBËTAR, KËRKOJNË PËRGJEGJËSI**



Deklaratë e hapur drejtuar institucioneve dhe përfaqësuesve politikë Shqiptarë mbi hapjen e Konsullatës Serbe në Shkodër.

“Përmbi za që lëshon bylbyli, gjuha shqipe m’kumbon...”
— *Ndre Mjeda*

Shkodra ka qenë gjithmonë një zë i gjallë i shpirtit Shqiptar. Ajo ka ruajtur ndër shekuj gjuhën, kulturën, artin dhe kujtesën e një kombi të tërë. Pikërisht për këtë arsye, çdo zhvillim që prek këtë qytet nuk mund të shihet vetëm si një çështje administrative apo diplomatike, por si një çështje që prek ndjeshmëri të thella historike dhe kombëtare.

Të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe të klasës politike Shqiptare,

Ne shprehim shqetësimin dhe kundërshtimin tonë ndaj vendimit për hapjen e një Konsullate Serbe në qytetin e Shkodrës, një vendim që kërkon një reflektim serioz institucional, kombëtar dhe qytetar.

Shkodra nuk është thjesht një qytet në hartën e Shqipërisë. Ajo është një nga vatrat më të rëndësishme historike, kulturore dhe kombëtare Shqiptare; djepi i artit, letërsisë, arsimit dhe traditës sonë kombëtare. Nga Shkodra kanë dalë figura të shquara që kanë kontribuar në identitetin kulturor dhe në zhvillimin e shoqërisë Shqiptare ndër breza.

Në këtë kontekst, vendosja e një përfaqësie diplomatike të një shteti fqinj në një qytet me një peshë kaq të madhe simbolike kërkon transparencë, konsultim publik dhe një analizë të kujdesshme të interesit kombëtar. Veçanërisht kur ngrihet pyetja se cili është qëllimi dhe nevoja konkrete e kësaj strukture në një qytet ku nuk ekziston një komunitet i konsiderueshëm Serb që të justifikojë një përfaqësi të tillë.

Po aq e rëndësishme është që marrëdhëniet dypalëshe të ndërtohen mbi parimin e reciprocitetit dhe respektit të ndërsjellë. Ndërsa në Shqipëri krijohen hapësira të reja diplomatike për Serbinë, mbetet e paqartë përse nuk trajtohet me të njëjtin seriozitet mbrojtja e interesave kombëtare Shqiptare. Në frymën e reciprocitetit, është legjitime që Shqipëria të mbrojë dhe të artikulojë me vendosmëri interesat e saj kombëtare.

(vazhdon në faqen pasardhëse)



Deklaratë e hapur drejtuar institucioneve dhe përfaqësuesve politikë Shqiptarë mbi hapjen e Konsullatës Serbe në Shkodër.

“Përmbi za që lëshon bylbyli, gjuha shqipe m’kumbon...”
— *Ndre Mjeda*

Po ashtu, është e arsyeshme të shtrohet çështja e reciprocitetit edhe në aspektin e përfaqësimit diplomatik. Shiptarët e Bujanocit dhe Medvegjës, komunitete autoktone me histori dhe prani të konsiderueshme në ato troje, meritojnë vëmendje dhe mbështetje institucionale për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Këto çështje nuk duhet të mbeten jashtë diskutimit sa herë që ndërmerren vendime që ndikojnë në balancën e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Pikërisht për këtë arsye, ne besojmë në marrëdhënie të mira diplomatike, por diplomacia nuk mund të shkëputet nga realiteti shoqëror, kujtesa historike dhe respekti për identitetin kombëtar të një vendi. Çdo veprim institucional duhet të garantojë që interesat e Shqipërisë dhe ruajtja e vlerave tona kulturore e kombëtare të jenë në qendër të vendimmarrjes.

Historia na ka mësuar se identitetet kombëtare dhe kulturore duhen mbrojtur me maturi, përgjegjësi dhe vetëdije. Shiptarët kanë të drejtë të kërkojnë që politikat publike të mos krijojnë pasiguri mbi ruajtjen e trashëgimisë, kulturës dhe interesave të vendit tonë.

U bëjmë thirrje institucioneve dhe klasës politike Shqiptare që këtë çështje ta trajtojnë me seriozitetin e duhur, me transparencë ndaj qytetarëve dhe me një qëndrim që vendos Shqipërinë, historinë dhe dinjitetin e saj kombëtar në plan të parë.